




www.ilpp.mk


Statistikat dhe komentimi i rezultateve nga anketa e realizuar për projektin “Parandalimi i migrimit të të rinjve në rajonin e Pollogut”,

Në anketën e projektit “Parandalimi i migrimit të të rinjve në rajonin e Pollogut” janë anketuar gjithësej 311 persona, dhe në vazhdim do të shohim se si qëndrojnë rezultatet e konstatuara nga statistikatat e anketës.

1. Prej të anketuarve 59% janë meshkuj dhe 41% femra.



2. Sa i përket moshës së të anketuarve rezultatet janë të paraqitura në vijim:




Nga numri i të përgjigurve, 159 janë që i përkasin moshës 18-25 vjeçare.

107 janë që i përkasin moshës 26-35 vjeçare,

31 janë që i përkasin moshës 36-45 vjeçare dhe


Vetëm 14 janë të moshës mbi 46 vjeçare.

3. Së treti është analizuar poashtu edhe vendbanimi se sa nga të anketuarit jetojnë në qytet dhe sa prej tyre në fshat.



Në bazë të rezultateve shohim se 45% e të anketuarve janë që banojnë në qytete, ndërsa pjesa e ngelur d.m.th 55% janë që banojnë në fshatra.

4. Në vazhdim janë të dhënat e përkatësisë etnike të të anketuarve.




Të anketuarit kanë prononcuar gjithësej tre përkatësi dhe ato janë:

përkatësia shqiptare me 304 pjesëmarrës,

përkatësia maqedonase me 6 pjesëmarrës

dhe përkatësia turke me vetëm 1 pjesëmarrës.

5. Janë tre nivele edukimi që të anketuarit kanë deklaruar.



Sa i përket arsimimit, të anketuarit posedojnë këto nivele:


254 persona janë me arsim të lartë,

48 persona janë me arsim të mesëm dhe

9 persona janë me arsim fillor.

6. Të anketuarit ishin me profesione të sferave të ndryshme, kryesisht ekonomistë, nëpunës të sektorit të shëndetësisë, juristë, dhe të sferave tjera.

7. Në pyetjen e parashtruar se çfarë paraqet migrimi për ata, nxorrëm këto përgjigje:



Nga pyetja se çfarë paraqet migrimi u konstatuan këto të dhëna:


226 persona janë të mendimit se migrimi është një mundësi më e mirë.

14 persona e konsiderojnë migrimin si kërcënim.

57 persona qëndrojnë në mes të dy opsioneve të para.

Ndërsa 14 persona nuk pajtohen me asnjërin opion të parashtruar.


8. Deklaratat e të anketuarve sipër pyetjes se a kanë anëtarë të familjes të migruar janë të paraqitura më poshtë:



92% e të anketuarve kanë familjarë që kanë migruar,

8% e të anketuarve nuk kanë familjarë të migruar.

9. Poshtë kemi opinionet e të anketuarve përse migrojnë:




154 persona janë të mendimit se jashtë mundësitë janë më të mëdha.

82 persona ndjehen të detyruar të migrojnë.

75 persona mendojnë se ka hapësirë edhe këtu.

10. Mënyrat e ndërmejtësimit për migrim në bazë të të anketuarve janë këto:



50% migrojnë me anë të lidhjeve familjare.

31% migrojnë përmes agjencioneve për punësim.

17% migrojnë nëpërmjet kontakteve personale.

2% migrojnë me anë të mënyrave tjera.

11. Zgjedhjet e të anketuarve për parandalimin apo motivimin e migrimit janë siç vijojnë:




62% do tentonin të parandalonin migrimin.

20% do të nxisnin migrimin.

18% nuk marrin pjesë në asnjërën prej alternativave.


12. Bindjet se a do të ktheheshin njerëzit nëse do ishin zgjedhur problemet që i kanë detyruar të migrojnë janë keto:



78% po, do ktheheshin sikur të ishin zgjidhur problemet që i kanë detyruar të migrojnë.

22% jo, nuk do të ktheheshin edhe nëse do zgjidheshin problemet që i kanë detyruar të migrojnë.

13. Banorët që janë të përcaktuar për të migruar do kishin dashur të drejtohen në këto fusha punësimi:



36% do kishin dashur të punësohen në fushën e industrisë.

18% do kishin dashur të punësohen në sektore të shëndetësisë.

9% do kishin dashur të punësohen në fushën e ndërtimitarisë.

4% do kishin dashur të punësohen në fushën e agrikulturës.

33% kanë synim të punësohen në fusha tjera.


14. Opinioni i banorëve se a ofron Maqedonia perspektivë është kështu:



89% mendojnë se shoqëria në Maqedoni nuk ofron perspektivë.

Ndërsa vetëm 11% janë të mendimit po, në Maqedoni ka perspektivë.

15. Faktorët më relevant që nxisin largimin nga vendi janë përzgjedhur siç vijon:



41% kanë zgjedhur papunësinë si faktor vendimtar që ka nxitur largimin nga vendi.

29% kanë zgjedhur se politizimi i organeve shtetërore është faktori që e nxit largimin nga vendi.

18% kanë zgjedhur mungesën e sundimit të së drejtës si faktor që nxit largimin.

5% kanë zgjedhur diskriminimin në baza etnike si faktor që inkurajon largimin nga vendi.

7% nuk kanë zgjedhur asnjë faktor të sipër përmendur se e nxit largimin nga vendi.

Dhe askush nuk ka zgjedhur bashkimin familjar si faktor që do inkurajonte largimin nga vendi.